

VENDIM
Nr. 39, datë 26.3.2026

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fiona Papajorgji	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Illir Toska	anëtar;
Genti Ibrahimi	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Asim Vokshi	anëtar;
Sonila Bejtja	anëtare,

me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 26.3.2026 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 12 (SH) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: SHOQËRIA “GFI ALBANIA” SH.P.K., ERGYS SELA, përfaqësuar nga avokatët Joana Qelesi dhe Ardian Karaj.

SUBJEKT I INTERESUAR:

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, përfaqësuar nga prokurori Klodjan Braho.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve “Për vleftësimin e sekuestrimit”, datë 22.2.2024, të Prokurorisë së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 159, datë 16.4.2024, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 101 (87-2024-146), datë 30.5.2024, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2024-1703, datë 17.10.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Dërgimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ose në alternativë në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 3, 15, 17, 35, 36, 37, 41, 42, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, 141 dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 8 Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*), si dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të saj; nenet 71, 71/a dhe 71/b të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuases, shoqërisë “GFI Albania” sh.p.k. (*kërkuesja e parë*) dhe kërkuessit Ergys Sela (*kërkuesi i dytë*), që kanë kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja e parë është një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar e themeluar si një bashkim operatorësh ekonomikë në kuadër të kontratës koncesionare nr. 14859/23 prot., datë 27.2.2013, “Për shërbimin e markimit dhe të monitorimit të karburanteve në Republikën e Shqipërisë” të lidhur me Ministrinë e Financave dhe të miratuar me vendimin nr. 200, datë 13.3.2013 të Këshillit të Ministrave (*kontrata e koncesionit*). Kërkuesi i dytë ka qenë administrator i saj nga data 1.2.2022 deri në datën 31.1.2025, në të cilën është larguar me vendimin e ortakut të vetëm të shoqërisë.

2. Në kuadër të procedimit penal nr. 279/1 të vitit 2023, të regjistruar për veprat penale “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë apo i të zgjedhurve vendorë” dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, të parashikuara nga nenet 260 dhe 287 të Kodit Penal (KP), Prokuroria e Posaçme ka kërkuar në gjykatë lejimin për kryerjen e kontrollit personal dhe të banesës për disa persona dhe shoqëri, duke pretenduar se nga hetimet krijohen dyshime dhe arsye të bazuara për të besuar se në zyrat e atyre shoqërive tregtare, përfshirë kërkuesen e parë, apo pranë kërkuesit të dytë, në cilësinë e administratorit të saj, mundet të fshihen dokumente, prova materiale ose sende që mund t’u përkasin veprave penale të dyshuara. Sipas tyre, një shtetas që ka zotëruar në mënyrë indirekte kapitalin e kërkueses së parë i ka kaluar personalisht ose nëpërmjet një shoqërie tregtare shuma monetare djalit të një ish-funksionari publik, me qëllim marrjen e përfitimeve financiare përmes kontratës së koncesionit.

3. Kjo kërkesë është pranuar nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*), gjyqtarja e hetimeve paraprake, me vendimin nr. 119, datë 19.2.2024, e cila ka lejuar kontrollin e zyrave të kërkueses së parë dhe kontrollin personal të kërkuesit të dytë (*vendimi për lejimin e kontrollit*). Ajo gjykatë ka vlerësuar se, në kuptim të nenit 202/a të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe nga analiza e të dhënave të marra gjatë hetimit paraprak deri në ato momente, ka arsye të bazuara për të menduar se në personat ose ambientet ku kërkohet të ushtrohet kontroll mund të gjenden prova materiale që lidhen me veprat penale të kryera nga ata ose mund të fshihen dokumente, të dhëna të memorizuara në formë elektronike apo prova të tjera materiale, të cilat mund të kenë vlerë provuese për natyrën e marrëdhënieve kontraktore, për qëllimin e kryerjes së transaksioneve, si dhe për parregullsi të mundshme në zhvillimin e procedurës së koncesionit të përfituar nga kërkuesja e parë, ose të dhëna të tjera që mund të kenë vlerë provuese për të vërtetuar marrjen e përfitimeve të parregullta nga funksionarët publikë të ngarkuar me kryerjen e kontrollit të procedurave të koncesionit.

4. Oficerët e policisë gjyqësore në Byronë Kombëtare të Hetimit (*oficerët e BKH-së*) dhe një ekspert kanë ekzekutuar vendimin e gjykatës në bazë të urdhrit “Për ekzekutimin e vendimit të kontrollit” të datës 19.2.2024 të prokurorit të çështjes. Ndër veprimet procedurale të kryera janë kontrolli i zyrave të kërkueses së parë dhe sekuestrimi i 61 sendeve të gjetura në të dhe të vlerësuar si prova materiale ose sende të lidhura me veprën penale (të pasqyruara në procesverbalin e kontrollit të vendeve të datës 20.2.2024 dhe procesverbalin për sekuestrimin e sendeve të po asaj date), si dhe kontrolli personal i kërkuesit të dytë dhe sekuestrimi i 2 aparateve celulare (të pasqyruara në procesverbalin për kontrollin personal të datës 20.2.2024 dhe procesverbalin për sekuestrimin e sendeve të po asaj date).

5. Prokurori i çështjes, me vendimin e datës 22.2.2024, i ka vleftësuar të ligjshme sekuestrimet e kryera nga oficerët e BKH-së dhe ka vendosur që ato të ruhen sipas kërkesave të nenit 214 të KPP-së. Ky vendim është kundërshtuar në gjykatë veçmas nga kërkuesja e parë dhe kërkuesi i dytë. Këto çështje janë bashkuar në vijim në seancë gjyqësore.

6. GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 159, datë 16.4.2024, ka vendosur rrëzimin e kërkesës ankimore të kërkuesve. Ajo gjykatë ka evidentuar fillimisht se objekt i gjykimit nuk është vendimi për lejimin e kontrollit, pasi ligji procedural penal nuk parashikon të drejtën e ankimit ndaj disponimit të gjykatës për lejimin e kontrollit, por vetëm ndaj disponimit për refuzimin e kërkesës për kontroll. Sipas saj, qëllimi i kontrolleve ka qenë për të gjetur dokumente, të dhëna të memorizuara, gjurmë ose prova materiale që mund të ndihmojnë hetimin e këtij procedimi penal dhe jo ndërhyrja në jetën private të të kontrolluarve. Pretendimin e kërkuesve se kontrolli është ushtuar pa iu dorëzuar atyre vendimi i Gjykatës për lejimin e kontrollit dhe pa pasur ata mundësinë që të kërkojnë praninë e një personi të besuar, ajo gjykatë e ka çmuar të pambështetur në prova, me arsyetimin se sekuestrimet janë kryer në ekzekutim të vendimit për lejimin e kontrollit dhe se sekuestrimi i sendeve është kryer në prani të avokatit A.V. Për pretendimin se sekuestrimi i aparateve celulare nuk është një sekuestrim i thjeshtë i një sendi dhe se oficerët e BKH-së duhet të kishin mbajtur parasysh dispozitat e KPP-së për korrespondencën, ajo gjykatë ka arsyetuar se referuar pikës 1 të nenit

209 të KPP-së qartazi nuk jemi përpara sekuestrimit të korrespondencës. Për më tepër, sipas saj, për shkak të kontrolleve nuk është cenuar ose penguar as veprimtaria e përditshme e shoqërisë, pasi të dhënat e sekuestruara nga kompjuterët janë kopjuar në hard disk të jashtëm dhe i janë vënë në dispozicion shoqërisë. Sipas GJKKO-së së Shkallës së Parë, vendimi i prokurorit për vleftësimin e sekuestrës, referuar pikës 2 të nenit 301 të KPP-së, duhet të jetë i motivuar, sikurse rezulton se është, dhe jo i arsyetuar, sikurse pretendohet se duhet të jetë. Si përfundim, ajo gjykatë e ka çmuar sekuestrimin e këtyre pajisjeve të domosdoshëm për nxjerrjen e të dhënave, e për pasojë të ligjshëm. Megjithatë, ajo gjykatë e ka orientuar prokurorin të tregojë dilijencën e duhur dhe në përfundim të ekspertimeve të operohet me kthimin e tyre, sipas rastit. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur apel kërkuesit.

7. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*), me vendimin nr. 101 (87-2024-146), datë 30.5.2024, ka vendosur të miratojë vendimin e GJKKO-së së Shkallës së Parë. Në referim të nenit 202 të KPP-së, ajo gjykatë ka vlerësuar se hetimet janë kryer në kuadër të një procedimi penal; se mbi të dhënat e marra gjatë hetimit paraprak deri në ato momente kanë ekzistuar arsye të bazuara për të menduar se në ambientet e kërkueses së parë ose tek kërkuesi i dytë mund të gjendeshin prova materiale që lidheshin me veprat penale për të cilat ishte regjistruar procedimi penal; se kryerja e kontrollit është bërë nga oficerët e BKH-së sipas përcaktimeve ligjore, duke u garantuar kërkuesve të drejta procedurale të parashikuara për këtë fazë. Në këtë drejtim, në lidhje me pretendimin e kërkuesve se nuk u është vënë në dispozicion vendimi i gjykatës për lejimin e kontrollit dhe se avokati ka mbërritur me vonesë për shkak të sekuestrimit të telefonit celular, sipas asaj gjykate: *“ky pretendim nuk gjendet i mbështetur për sa kohë nuk mund të provohet me asnjë akt/provë”*. Më tej, ajo gjykatë ka evidentuar se në procesverbalin e kontrollit personal të kërkuesit të dytë është vënë vetëm shënimi: *“refuzon të japë kodin e hapjes”*, ndërsa në procesverbalet e sekuestrimit janë vendosur shënimet: *“nuk jam dakord për sekuestrimin e telefonit, pasi është personal”*, dhe: *“nuk jam dakord, pasi është tejkaluar objekti i kontrollit”* (shih faqet 22–23 të vendimit të GJKKO-së së Apelit). GJKKO-ja e Apelit e ka çmuar të drejtë qëndrimin e prokurorit që ka vleftësuar të ligjshme sekuestrimet e kryera me argumentin, se: *“ka dyshime se mbi sendet mund të gjenden gjurmë dhe sende që mund të ndihmojnë në sqarimin e rrethanave të çështjes”*, argument që përputhet, sipas saj, me kuptimin që ligji procedural i jep provës materiale. Po kështu, ajo gjykatë ka vlerësuar se sekuestrimi në rastin konkret është realizuar në zbatim të vendimit të gjykatës që ka lejuar kontrollin. Lidhur me proporcionalitetin, GJKKO-ja e Apelit ka arsyetuar se në rastin objekt gjykimi Prokuroria e Posaçme po heton për dy vepra penale, të parashikuara nga nenet 260 e 287 të KP-së, arsye për të cilën sekuestrimi i sendeve ka ndjekur një qëllim provues dhe të drejtë.

8. Në lidhje me pretendimin se në vendimin e kontrollit nuk janë përmendur sendet që duhet të kontrollohen ose sekuestrohen dhe janë kapërcyer kompetencat e vendimit të gjykatës për kontrollin, duke iu referuar kryesisht aparateve celulare, ajo gjykatë ka arsyetuar se veprimet e kontrollit dhe të sekuestrimit janë kryer nga oficerët duke u bazuar në nenet 202–205, 207, 298, 300, 301 dhe 303 të KPP-së, pasi i kanë konsideruar si sende që përmbajnë të dhëna me rëndësi për faktet objekt hetimi. Në këto rrethana, ajo gjykatë, duke mbështetur gjykatën e shkallës së parë, e ka çmuar të bazuar në nenin 300, pika 2, të KPP-së, të kombinuar me nenin 187 të saj, veprimin e sekuestrimit të sendeve, si njësi kompjuterike, hard disk, telefona celularë dhe USB, nga ana e oficerëve të BKH-së dhe vendimmarrjen e prokurorit për vleftësimin të ligjshme. Pretendimin se janë shkelur neni 208/a i KPP-së dhe vendimi njësuës i Gjykatës së Lartë, ajo gjykatë e ka gjetur të pabazuar, me arsyetimin se sendet, përfshirë edhe pajisjet elektronike, njësi kompjuterike, hard disk dhe telefona celularë e USB, janë sekuestruar si sende në kuptim të neneve 187 dhe 191 të KPP-së, pra sende që me të dhënat ose gjurmët që mund të përmbajnë shërbejnë si prova materiale që mund të ndihmojnë zbardhjen e fakteve objekt hetimi, duke evidentuar se në rastin e sekuestrimit të telefonave, njësive kompjuterike ose hard disk e USB, nuk kemi të bëjmë me sekuestrim të dhënash ose sistemesh kompjuterike, por thjesht me sekuestrim sendesh që mund të shërbejnë si prova materiale.

9. Lidhur me pretendimin për shkeljen e nenit 8 të KEDNJ-së dhe neneve 36 dhe 37 të Kushtetutës, ajo gjykatë ka arsyetuar se e drejta themelore për mbrojtje të jetës personale dhe familjare nuk është një e drejtë absolute, por duhet të trajtohet në raport me funksionin e saj në shoqëri. Në nenin 17 të Kushtetutës, ku është përcaktuar se kufizimet e të drejtave, që bëhen përmes ligjit, për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve, duhet të jenë në përpjesëtim me të drejtën që e ka diktuar atë. Në rastin konkret, ajo gjykatë ka çmuar se ndërhyrja është bërë me ligj, konkretisht nenet 202–207 të KPP-së, pra detyrimi për parashikimin e ndërhyrjeve me ligj në kuptimin formal rezulton të jetë respektuar, kufizimet janë kryer për një interes publik dhe në kuadër të një hetimi nga Prokuroria e Posaçme. Masa e vendosur ka si qëllim të identifikojë personat përgjegjës lidhur me procedimin penal dhe prokurori ka theksuar se me këtë veprim kontrolli është synuar gjetja e provave materiale në drejtim të identifikimit të përgjegjësisë së personit juridik (kërkueses së parë) ose personat që “fshihen” pas saj, përfshirjen e shoqërisë në rrethanat objekt të hetimeve të këtij procedimi penal në vitet 2022–2024, kohë kur ka qenë administrator pikërisht kërkuesi i dytë. Lidhur me pretendimin se sekuestrimi i pajisjeve elektronike shkel të drejtën e lirisë dhe fshehtësisë së korrespondencës, pasi në to ka korrespondencë me të tretë ose personale, ajo gjykatë ka arsyetuar se nuk qëndron, pasi këto marrëdhënie me “të tretët” nuk ndikohen nga sekuestrimi i sendeve të sipërcituara dhe se qëllimi i organit procedues është të përdorë informacionet e marra nga provat materiale të sekuestruara vetëm për qëllim të hetimit. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur rekurs të dy kërkuesit.

10. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00–2024–1703, datë 17.10.2024, ka vendosur mospranimin vetëm të rekursit të paraqitur nga kërkuesi i dytë, me arsyetimin se ai nuk përmbante asnjë nga shkaqet e përcaktuara në nenin 432 të KPP-së, ndërsa nuk është shprehur dhe as nuk e ka pasqyruar në vendim rekursin e kërkueses së parë. Ai kolegji ka vlerësuar se gjykatat e faktit e kanë arsyetuar mjaftueshëm vendimmarrjen e tyre dhe se shkaqet e paraqitura në rekurs marrin përgjigje të plotë dhe të argumentuar mjaftueshëm në vendimmarrjen e gjykatës së apelit, ndërsa nuk ka konstatuar moszbatim të ligjit penal (material ose procedural) nga ana e asaj gjykate, me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, nuk ka konstatuar shkelje procedurale me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave, si dhe nuk ka rezultuar që vendimi i rekursuar të jetë në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

11. Në datën 25.4.2025 kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë sipas objektit, e cila, pasi është plotësuar në përputhje me parashikimet ligjore, është regjistruar në datën 5.5.2025. Kolegji i Gjykatës, me vendimin e datës 16.7.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

12. **Kërkuesit**, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se u janë cenuar:

12.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të së drejtës së aksesit të lidhur me *standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe parimin e sigurisë juridike*, pasi Gjykata e Lartë nuk është shprehur për pretendimet e ngritura në rekurs. Në vendimin e saj, ndonëse paraqet si rekursues të dy kërkuesit, ka renditur vetëm shkaqet e rekursit të kërkuesit të dytë dhe ka disponuar vetëm për të dhe jo për kërkuesen e parë. Gjithashtu, vendimet e kundërshtuara bien ndesh me vendimin njësuës nr. 147, datë 23.12.2021, të Gjykatës së Lartë, për shkak të mosrespektimit të kriterëve të përcaktuara në të për lejitimin e sekuestrimit të të dhënave ose sistemeve kompjuterike.

12.2. *E drejta për jetë private* në aspektin e mbrojtjes të të dhënave personale, lirisë dhe fshehtësisë së korrespondencës dhe paprekshmërisë së banesës, të garantuara nga nenet 35, 36 dhe 37 të Kushtetutës dhe neni 8 i KEDNJ-së, duke u bazuar në disa argumente:

12.2.1. Vendimi për lejimin e kontrollit është i paligjshëm, për shkak se është i përgjithshëm dhe nuk përcakton se cilat sende/dokumente do t'i nënshtroheshin kontrollit dhe eventualisht sekuestrimit. Neni 207 i KPP-së përcakton se sendet e gjetura gjatë kontrollit sekuestrohen, me kusht që të jenë të përcaktuara në vendimin për lejimin e kontrollit. Duke vendosur sekuestrimin e telefonave celularë të legjitimuar nga një vendim evaziv i kontrollit, kërkuesit të dytë i është shkaktuar një cenim i pajustificuar në të drejtën e tij për jetë private, duke qenë se nga mënyra si është operuar, të dhëna të tjera të gjendura në ata telefona janë bërë të aksesueshme për oficerët e BKH-së.

12.2.2. Ai vendim është i paligjshëm edhe për shkak të mungesës së lidhjes logjike midis ngjarjes objekt hetimi, kontrollit të ushtruar dhe sendeve të sekuestruara në kuadër të kontrollit. Vendimi i Këshillit të Ministrave që ka miratuar kontratën e koncesionit daton mbi 10 vjet më parë, ndërsa kërkuesi i dytë ka ushtruar funksionin e administratorit të kërkueses së parë shumë vite më vonë (2022–2024).

12.2.3. Prokuroria e Posaçme dhe gjykatat nuk kanë arsyetuar për dyshimin e arsyeshëm të konkretizuar dhe të individualizuar për rastin konkret lidhur me mundësin e gjetjes së sendeve dhe provave që lidhen me veprën penale. Duke marrë parasysh se kontrolli si mjet i kërkimit të provës, i pasuar nga sekuestrimi, lidhet me kufizimin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, nevojitet të bëhet në përputhje me nenin 17 të Kushtetutës. Vendimet e kundërshtuara janë antikushtetuese për shkak të mosrespektimit të parimit të proporcionalitetit, por edhe të parimit të domosdoshmërisë, pasi prokuroria dhe gjykatat nuk kanë arsyetuar se cila ka qenë nevoja e sekuestrimit të sendeve me iniciativë të oficerëve të BKH-së.

12.2.4. Oficerët e BKH-së kanë tejkaluar vendimin e gjykatës, duke vendosur sekuestrimin e korrespondencës së kërkueses së parë dhe të disa punonjësve të saj, si dhe telefonat celularë të kërkuesit të dytë. Në vendimin për lejimin e kontrollit nuk përcaktohet se duhet të kontrollohen dhe më pas të sekuestrohen korrespondenca dhe telefonat celularë. Oficerët e BKH-së kanë proceduar drejtpërsëdrejti me sekuestrimin e sendeve, pa u kryer kontrolli i tyre më parë, pra sekuestrimi nuk ka ardhur si pasojë e kontrollit, por vendimi për lejimin e kontrollit është përdorur si mjet për realizimin e qëllimit të vetëm, sekuestrimin e korrespondencës dhe të dhënave kompjuterike. Pra, del e qartë se oficerët kanë vepruar me iniciativën e tyre, në tejkalim të vendimit gjyqësor. Për më tepër, ata kanë sekuestruar çdo send të gjetur, pa verifikuar më parë rëndësinë e tyre në raport me atë që synohet të gjendet.

12.2.5. Në vendimin e vleftësimit të sekuestrimit të sendeve prokuroria ka dështuar të përcaktojë domosdoshmërinë e këtyre sendeve, shkelje e cila nuk është konstatuar as nga gjykatat. Përgjatë rregullit i përgjithshëm bën rasti kur gjatë kontrollit oficerët e BKH-së gjejnë sende që nuk përfshihen në vendimin për lejimin e kontrollit, por që lidhen me veprën penale. Në rastin konkret sendet e sekuestruara nuk kanë asnjë lidhje me kryerjen e ndonjë veprë, madje pjesa më e madhe e tyre aksesohen *online*. Në këtë kuptim, evidentohet se janë sekuestruar në bllok të gjitha sendet e gjetura, duke mos u shqetësuar aspak për veçimin e sendeve që nuk lidheshin me procedimin penal.

12.2.6. Mosrespektimi i modaliteteve në lidhje me sekuestrimin e të dhënave dhe pajisjeve kompjuterike, si rezultat i të cilit mund të ekspozohen të dhëna të tjera që nuk kanë lidhje me faktin penal.

12.2.7. Kontrolli është ushtruar pa iu dorëzuar kërkuesve vendimi i kontrollit, si dhe pa iu dhënë mundësia të kërkojnë praninë e një personi të besuar. Në lidhje me këtë pretendim nga ana e gjykatave është mbajtur një qëndrim tërësisht formal, duke arsyetuar se ky pretendim nuk mund të provohet me asnjë provë. Në fakt, këto pretendime vërtetohen nga pamjet e kamerave ambientale, si dhe nga fakti se kërkuesi i dytë i ka telefonuar avokatit nga telefoni i oficerit të BKH-së.

12.3. *E drejta e pronës private*, e garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, si rrjedhojë e kontrollit dhe sekuestrimit të paligjshëm të sendeve të kërkuesve.

13. **Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme**, nuk ka paraqitur prapësime në lidhje me pretendimet e kërkuesve për cenimin e *procesit të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, por, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar sa vijon:

13.1. Pretendimi për cenimin e së drejtës për jetë private, të garantuar nga nenet 35–37 të Kushtetutës, nuk qëndron, pasi:

13.1.1. Kontrolli personal, në të kundërt nga sa pretendohet, është në përputhje me kufizimin e lejuar nga pika 3 e nenit 37 të Kushtetutës, pasi është urdhëruar nga gjykata për hetimet paraprake në një proces penal në përputhje me nevojat e procedimit dhe parashikimet në nenet 202–205 dhe 207 të KPP-së. Organi procedues ka si qëllim të përdorë informacionet e marra nga provat materiale të sekuestruara në bazë të vendimit për lejimin e kontrollit, vetëm për të bërë të mundur zbulimin e të dhënave që mund të çojnë në identifikimin e personave përgjegjës që dyshohet se mund të kenë kryer vepra penale. Ky fakt përforcohet nga diligenca e organit procedues, pasi oficerët e BKH-së, në prezencë të ekspertit të BKH-së dhe specialistit të IT-së të kërkueses së parë, i kanë vënë në dispozicion shoqërisë kopje të të gjithë të dhënave që janë gjetur në njësitë kompjuterike të sekuestruara.

13.1.2. E drejta themelore për jetë personale dhe familjare nuk është një e drejtë absolute, referuar edhe jurisprudencës së GJEDNJ-së, por duhet të trajtohet në raport me funksionin e saj në shoqëri. Neni 17 i Kushtetutës ka përcaktuar se kufizimet e të drejtave që bëhen përmes ligjit, për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve, duhet të jenë në përpjesëtim me të drejtën që e ka diktuar atë. Në rastin konkret ndërhyrja është bërë në referim të neneve 202–207 të KPP-së, në këtë kuptim detyrimi për parashikimin e ndërhyrjeve me ligj në kuptimin formal është respektuar. Ashtu siç ka vlerësuar edhe Gjykata e Lartë, arsyet e paraqitura nga prokurori janë “relevante dhe të mjaftueshme” dhe “proporcionale me synim legjitim të ndjekur”. Kërkimi i prokurorisë dhe miratimi nga gjykatat për lejimin e kontrollit janë bazuar në një vlerësim të arsyeshëm të fakteve. Masa e vendosur ka si qëllim të identifikojë personat përgjegjës lidhur me procedimin penal dhe me këtë veprim kontrolli është synuar gjetja e provave materiale në drejtim të identifikimit të përgjegjësisë së personit juridik ose personat që fshihen pas tij, si dhe përfshirja e shoqërisë në rrethanat objekt të hetimeve në vitet 2022–2024 kur administrator ka qenë kërkuesi i dytë.

13.1.3. Sekuestrimi i provave materiale, përfshirë akte/fashikuj, telefona, USB, njësi kompjuterike, hard disqe, është i justifikuar referuar nenit 17 të Kushtetutës. Kufizimet janë kryer për një interes publik në kuadër të një hetimi nga Prokuroria e Posaçme, e cila është duke hetuar për dy vepra penale të parashikuara nga nenet 260 dhe 287 të KP-së dhe, për këto arsye, sekuestrimi i sendeve ka ndjekur një qëllim provues dhe të drejtë, pasi nëpërmjet ekzaminimit të sendeve të sekuestruara organi procedues kërkon të marrë të dhëna për të bërë të mundur identifikimin e personit/ave përgjegjës lidhur me faktin nëse ka veprime të dyshuara si fiktive ose korruptive në kuadër të hetimit të zhvilluar për procedimin penal në fjalë.

13.1.4. Nuk ka cenim të veprimtarisë së shoqërisë ose pengim të aktivitetit tregtar të saj, pasi oficerët e BKH-së i kanë dhënë shoqërisë kopje të të gjitha të dhënave që janë gjetur në njësitë kompjuterike të sekuestruara.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesve

14. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

15. Në lidhje me legjitimitimin *ratione personae*, Gjykata ka theksuar se në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, individ mund të

bëjë ankim kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me të drejtat themelore të tij, duke treguar se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimet nr. 21, datë 22.4.2025; nr. 17, datë 13.3.2024; nr. 44, datë 26.9.2023, të Gjykatës Kushtetuese*). Kjo do të thotë se kërkuesi duhet të provojë legjitimitimin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial (*shih vendimin nr. 29, datë 16.4.2024, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithashtu, në kuptim të nenit 16 të Kushtetutës, të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa përputhen me qëllimet e përgjithshme të tyre dhe me thelbin e këtyre të drejtave e lirive.

16. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata vëren se kërkuesit kanë kundërshtuar vendimin e GJKKO-së së Shkallës së Parë për lejimin e kontrollit të zyrës së kërkueses së parë dhe atë personal të kërkuesit të dytë, mënyrën e zbatimit të tij nga oficerët e BKH-së, sikundër edhe vendimin për vlefhtësimin e masës së sekuestrimit për qëllime provuese të prokurorit, si dhe vendimet gjyqësore që kanë rrëzuar ankimin e tyre, me pretendimin se masa dhe veprimi hetimor në fjalë, si dhe ligjërimi i tyre nga gjykatat e zakonshme kanë ndërhyrë drejtpërdrejt në të drejtat themelore të tyre. Në këto kushte, Gjykata çmon se kërkuesit kanë qenë palë në proces dhe justifikojnë interesin në çështjen e parashtruar dhe, për rrjedhojë, legjitimohen *ratione personae*.

17. Për sa i takon kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, duke pasur parasysh se vendimet e ndërmjetme të sekuestrimit provuese, të zbatuara gjatë hetimeve paraprake, i janë nënshtruar kontrollit kushtetues duke u konsideruar si vendime përfundimtare, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, për sa kohë ndërhyjnë në të drejtat kushtetuese individuale (*shih vendimet nr. 42, datë 1.7.2025; nr. 21, datë 22.4.2025, të Gjykatës Kushtetuese*), si dhe faktin se pretendimet në ankimin kushtetues individual kërkuesit i kanë paraqitur më parë, në formë dhe në substancë, përpara gjykatave të zakonshme, Gjykata vlerëson se ata nuk kanë mjete të tjera juridike në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual, ndaj edhe ky kriter plotësohet.

18. Kërkuesit legjitimohen edhe *ratione temporis*, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë mban datën 17.10.2024 dhe është publikuar në faqen zyrtare të asaj gjykate në datën 23.12.2024, ndërsa ankimi kushtetues individual është dërguar nëpërmjet shërbimit postar në datën 15.4.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

19. Në drejtim të legjitimitimit *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuesit kanë pretenduar cenimin e së drejtës për jetë private në disa aspekte, për shkak të kontrolleve të ushtruara dhe sekuestrimit të pajisjeve dhe të dhënave kompjuterike që i kanë pasuar ato, ndërsa kanë kundërshtuar vendimet e gjykatave të posaçme, duke pretenduar edhe cenimin e së drejtës për proces të rregull ligjor në disa aspekte, si dhe drejtën për pronë private.

20. Lidhur me pretendimin për cenimin e së drejtës së pronës private, sipas nenit 41 të Kushtetutës, Gjykata evidenton se kërkuesit nuk kanë paraqitur ndonjë argument kushtetues në mbështetje të tij, por janë përqendruar vetëm tek e drejta për mbrojtjen e të dhënave personale dhe fshehtësinë e korrespondencës. Për këto arsye, Gjykata çmon se ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim.

21. Për sa i përket pretendimit për cenimin e së drejtës për jetë private, Gjykata vëren se kërkuesit e kanë argumentuar atë në aspektin e mbrojtjes të të dhënave personale, lirisë dhe fshehtësisë së korrespondencës dhe paprekshmërisë së banesës, të garantuara nga nenet 35, 36 dhe 37 të Kushtetutës. Nga ana tjetër, kërkuesit kanë pretenduar edhe cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe parimin e sigurisë juridike, duke argumentuar se Gjykata e Lartë nuk është shprehur për rekursin e paraqitur nga kërkuesja e parë, ndërsa lidhur me rekursin e kërkuesit të dytë ajo gjykatë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve me natyrë kushtetuese, konkretisht atyre në lidhje me tri aspektet e së drejtës për jetë private të pretenduar si të cenuar.

22. Gjykata, në konsideratë të jurisprudencës së saj të konsoliduar, sipas së cilës kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese të procesit të rregullt ligjor është funksion edhe i

gjykatave të zakonshme **dhe, në mënyrë të veçantë**, i Gjykatës së Lartë (*shih vendimin nr. 6, datë 16.2.2021, të Gjykatës Kushtetuese*), çmon që fillimisht t'u japë përgjigje pretendimeve të kërkuësve për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë në lidhje me të drejtën e ankimit substancial dhe standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor dhe, më pas, të kontrollojë pretendimet e tyre për shkeljen e të drejtave substanciale.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë në lidhje me të drejtën e ankimit substancial dhe standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor

23. Kërkuësit kanë pretenduar se Gjykata e Lartë nuk i ka analizuar shkaqet e rekursit të kërkuësve së parë dhe nuk ka disponuar për të, ndonëse e paraqet si rekursuese në vendim. Për sa i takon kërkuësit të dytë, ajo gjykatë nuk është shprehur për pretendimet me natyrë kushtetuese të ngritura në rekursin e tij, duke mosrespektuar kriteret e përcaktuara nga vetë ajo në vendimin njësuës nr. 147, datë 23.12.2021 për lejimin e sekuestrimit të të dhënave ose sistemeve kompjuterike. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, nuk ka paraqitur ndonjë prapësim për këtë pretendim.

24. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta e aksesit në gjykatë nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substancial dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 32, datë 3.11.2022; nr. 5, datë 22.2.2022; nr. 22, datë 29.4.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa u përket vendimeve të Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit, Gjykata ka theksuar se ato mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Ky arsyetim i kufizuar nuk cenon standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, përderisa, në thelb, shpreh shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 10, datë 7.3.2023; nr. 2, datë 11.2.2021; nr. 21, datë 16.4.2015, të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, Gjykata ka pohuar se standardi i arsytimit është i lidhur edhe me respektimin e së drejtës së aksesit në gjykim dhe së drejtës së ankimit efektiv. Në rastet kur kërkuësi nuk merr përgjigje për pretendimet e tij me natyrë kushtetuese, për shkak të vendimit të mospranimit të rekursit, i cenohet jo vetëm standardi i arsytimit të vendimit, por edhe e drejta e aksesit, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, si dhe e drejta e ankimit në kuptimin substancial, e parashikuar në nenin 43 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 25, datë 5.3.2026; nr. 1, datë 26.1.2021; nr. 45, datë 3.7.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas saj, Gjykata e Lartë, **në kuadër** të parimit të *subsidiaritetit* që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në ekzaminimin e pretendimeve të natyrës kushtetuese të ngritura në rekurs dhe të mbajë një qëndrim të shprehur për to (*shih vendimin nr. 11, datë 16.4.2018, të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Nën dritën e standardeve kushtetuese të mësipërme, si dhe duke pasur parasysh natyrën dhe thelbin e pretendimeve të kërkuësve, Gjykata në vijim do të kontrollojë nëse Gjykata e Lartë i ka marrë në shqyrtim shkaqet e rekursit të kërkuësve së parë dhe nëse ka disponuar për to, në respektim të së drejtës së aksesit në gjykatë të lidhur me të drejtën e ankimit substancial, duke iu referuar për këtë qëllim arsytimit të vendimit të Gjykatës së Lartë. Po kështu, Gjykata do të verifikojë nëse pretendimi për cenimin e së drejtës për jetë private të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit nga gjykatat e posaçme, duke qenë me natyrë kushtetuese, ka qenë i tillë që të kërkonte një përgjigje të shprehur dhe të arsyetuar nga Gjykata e Lartë përpara se ai pretendim, në respektim të parimit të subsidiaritetit, t'i nënshtrohej kontrollit kushtetues.

26. Referuar dosjes gjyqësore të administruar për qëllim të shqyrtimit të çështjes në seancë plenare, në datën 14.8.2024 pranë GJKKO-së së Apelit ka depozituar rekurs kërkuësi i dytë (nr. R-206). Po në të njëjtën datë ka depozituar rekurs edhe kërkuësja e parë (nr. R-207). Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, edhe pse në pjesën hyrëse të vendimit në përcaktimin e palëve ndërgjyqëse ka pasqyruar të dy kërkuësit, në pjesën ku parashtrihen palët që kanë paraqitur rekurs ndaj vendimit të gjykatës së apelit dhe shkaqet përkatëse, ka dështuar të rendisë të dy kërkuësit si rekursues, duke evidentuar në vendim vetëm rekursin e kërkuësit të dytë. Në këtë kuptim, ai kolegji ka marrë në shqyrtim vetëm shkaqet e rekursit të kërkuësit të dytë, për

të cilin ka arritur në përfundimin se ai nuk përmbante asnjë nga shkaqet e përcaktuara në nenin 432 të KPP-së dhe se shkaqet e paraqitura në rekurs marrin përgjigje të plotë dhe të argumentuar mjaftueshëm në vendimarrjen e gjykatës së apelit. Në përfundim, Gjykata e Lartë ka disponuar vetëm për të dhe jo për rekursin e palës tjetër, të cilin, siç u tha më lart, nuk e ka përmendur, ndonëse ishte pjesë e dosjes gjyqësore.

27. Nga sa më sipër, Gjykata eidenton se, ndonëse në pjesën hyrëse të vendimit të Gjykatës së Lartë është pasqyruar se çështja penale konkrete ka dy palë kërkuuese (kërkuesen e parë dhe kërkuesin e dytë), më tej në atë vendim janë pasqyruar vetëm shkaqet e rekursit të kërkuesit të dytë dhe nuk është pasqyruar asnjë nga shkaqet e rekursit të kërkueses së parë dhe as nuk është disponuar për to. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se duke vepruar në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë i ka mohuar plotësisht kërkueses së parë (shoqërisë “GFI Albania” sh.p.k.) të drejtën e aksesit në gjykatë në lidhje me të drejtën e ankimit substancial, në kuptim të marrjes përgjigje për pretendimet e ngritura në rekurs. Po kështu, Gjykata vëren se kërkuesi i dytë në rekurs ka ngritur një pretendim me natyrë kushtetuese, atë për cenimin e së drejtës për jetë private, për shkak të mosrespektimit të modaliteteve të sekuestrimit të të dhënave dhe pajisjeve kompjuterike, që mund të ekspozojë të dhëna të tjera që nuk kanë lidhje me faktin penal. Ndonëse Gjykata e Lartë e ka pasqyruar këtë pretendim në pjesën përshkruese të shkaqeve të rekursit, ajo nuk ka mbajtur një qëndrim të shprehur dhe konkret ndaj tij. Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje të shprehur pretendimit kushtetues të kërkuesit të dytë (Ergys Sela) për mënyrën se si kishin vepruar prokuroria dhe gjykatat e posaçme në kontrollin dhe sekuestrimin e pajisjeve dhe të dhënave kompjuterike.

28. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se çështja duhet të merret sërish në shqyrtim nga Gjykata e Lartë, e cila duhet të vlerësojë shkaqet e rekursit të kërkueses së parë dhe të shprehet lidhur me to, si dhe të mbajë një qëndrim të shprehur dhe të arsyetuar për pretendimin me natyrë kushtetuese të ngritur në rekursin e kërkuesit të dytë, duke konsideruar lidhjen ndërmjet shkaqeve të dy rekurseve. Prandaj, nisur nga roli i Gjykatës së Lartë në kuadër të parimit të subsidiaritetit, Gjykata çmon të mos ndalet në analizimin e mëtejshëm të tij, përtej konstatimit të faktit se Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë një përgjigje të shprehur dhe të arsyetuar këtij pretendimi, vlerësimi i mëtejshëm i të cilit i takon, në radhë të parë, Gjykatës së Lartë.

29. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesve për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë në lidhje me të drejtën e ankimit substancial dhe standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor është i bazuar, sipas arsytimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa pranohet pjesërisht.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.
 2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-1703, datë 17.10.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
 3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 26.3.2026.

Shpallur më 7.5.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji

Anëtarë: Sandër Beci, Marsida Xhaferllari, Marjana Semini, Genti Ibrahim, Ilir Toska,
Sonila Bejtja, Asim Vokshi